



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 113, datë 07.08.2019

PËR MIRATIMIN E EKSPERTËVE PËR VLERËSIMIN E NIVELIT TË ZOTËRIMIT TË GJUHËVE TË HUAJA, TË DEKLARUARA NGA KANDIDATËT E LEJUAR PËR VENDET VAKANTE

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 229 dhe të pikës 5 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, pikës 44 të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Miratimin e ekspertëve për vlerësimin e nivelit të zotërimit të gjuhëve të huaja, të deklaruar nga kandidatët e lejuar për vendet vakante, si më poshtë:

a) Dr. Adelina Albrahimi, pedagoge e brendshme e gjuhës angleze, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

b) Prof.As. Aida Gjinali, pedagoge e brendshme e gjuhës italiane, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

Ardian Dvorani

